



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA GRAMSH
SEKTORI I BURIMEVE NJERËZORE

Nr. 1057 / 1. Prot.

Datë 23.03.2022

Lënda: Kthim-përgjigje shkresës suaj datë 09.03.2022.

**Z.ILIR PASHAJ (Zyra 2-katëshe ngjitur me Prokurorinë e rrethit Elbasan)
ELBASAN**

Në përgjigje të shkresës suaj datë 09.03.2022 "Kërkesë", protokolluar me tonën nr.1057, datë 10.03.2022, ju bëjmë me dije se një pjesë e dokumentave si(akti i emërimit, kontrata e punës) nuk gjendet në dosje, pasi kjo dosje është transferuar nga Zyra Arsimore me mungesë dokumentacioni në 01.12.2015, datë e cila përkon edhe me fillimin e punës pranë Bashkisë Gramsh (vërtetohet edhe nga librezja e punës) ndërsa librezja e punës është tërhequr nga ish-punonjësi Z.Tomorr Llapushi më datë 18.03.2022.

Bashkëlidhur do të gjeni fotokopje të dokumentave të kërkuara nga ana Juaj , të cilat gjenden në dosje,si më poshtë:

1. Arsimimin(fotokopje e vërtetimit të shkollës).
2. Vendimin nr.98, datë 18.06.2021 "Për një ndryshim të Vendimit nr.24, datë 11.02.2021"Për miratimin e Strukturës Organizative dhe Njësive vartëse të saj për vitin 2021"(Akti i Ristrukturimi).
3. Vendimin nr.117, datë 05.07.2021 "Për përfundim të marrdhënies së punës".
4. Aktet shkresore që vërtetojnë kryerjen e procedurave për zgjidhjen e marrdhënies së punës (shkresa nr.2258, datë 21.06.2021 "Njoftimi për fillimin e procedurave për përfundim të marrdhënies së punës"; proces-verbali nr.2358, datë 24.06.2021;lajmërim-marrje e konfirmuar nga Z.Tomorr Llapushi më datë 21.06.2021; shkresa nr.2258/3, datë 28.06.2021 "Njoftimi për vazhdimin e procedurave për përfundim të marrdhënies së punës"; proces-verbali nr.2470,datë 02.07.2021; lajmërim-marrje e pakonfirmuar nga Z.Tomorr Llapushi më datë 02.07.2021; shkresa nr.2258/6, datë 05.07.2021, "Njoftimi për vazhdimin e procedurave për përfundim të marrdhënies së punës"; lajmërim-marrje e pakonfirmuar nga Z.Tomorr Llapushi më datë 05.07.2021; shkresa nr.2495/1, datë 06.07.2021 "Njoftim për përfundim të marrdhënies së punës"; lajmërim-marrje e pakonfirmuar nga z.Tomorr Llapushi)

Ish-punonjësi z.Tomorr Llapushi ka edhe 1 (një) masë disiplinore në dosje dhe 1(një) raport 7-ditor për paaftësi të përkoheshme që paguhen nga punëdhënësi.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

Konceptoi:J.Llapushi
Pranoi: E.Koçi
Miratoi: A. Shuli
Konfirmoi:--/
Afat i ruajtës: 10 vjet

KRYETARI

Klodian TAÇE

